


PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.



N.Sh.”Univerzum Audit”  
Prishtinë: Qendra Tregtare “Bregu i diellit”, Nr.26  
Tel. 044-124-898 & 044-500-877  
E-mail: [info@univerzumaudit.com](mailto:info@univerzumaudit.com)  
[www.univerzumaudit.com](http://www.univerzumaudit.com)



05-373 25.02.2010  
PRISHTINE - PRISHTINA

**PASQYRAT FINANCIARE DHE  
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR  
PËR VITIN QË PËRFUNDON ME 31 DHJETOR 2009**

**N.H.,Iber -Lepenc,, SH.A.**

**Përmbajtja:**

Raporti i auditorit të pamvarur.....	4
Informata të përgjithshme mbi entitetin.....	6
Pasqyra e të ardhurave.....	7
Bilanci i gjendjes.....	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë gatshme.....	9
Pasqyra e ndërrimeve në ekuitet.....	10
Pasqyra e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.....	11
Njohja dhe vlersimi i kontrollit të mbrendshëm.....	20

**Shkurtesat e përdorura:**

**SNA-** Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

**SNK-** Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

**SKK-** Standardet Kosovare të Kontabilitetit

**ATK-** Administrata Tatimore e Kosovës

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### PËR MENAXHMENTIN E N.H.”IBER-LEPENC” SH.A

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të N.H.,Iber -Lepenc,,SH.A që përbëhen prej Bilancit të Gjendjes deri më 31 Dhjetor 2009 , Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e ndërrimeve në ekuitet dhe Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme për vitin që ka përfunduar, dhe përmbledhjen e politikave kryesore të kontabilitetit dhe shënimet tjera sqaruese.

Përgjegjësi e menaxhmentit të shoqërisë është përgaditja dhe prezentimi i drejtë i këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë. Kjo përgjegjësi përfshinë : dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të mbrendshëm që është i rëndësishëm për përgaditjen dhe prezentimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion lidhur me këto pasqyra financiare të bazuar në auditimin i cili është kryer nga ana jonë.

Me përjashtim sa trajtohet në paragrafin vijues, ne e kemi kryer auditimin duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe këto standarde kërkojnë që ne ti pëmbushim kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar sigurinë e arsyeshme se a janë pasqyrat financiare pa deklarata të gabuara materiale.

Auditimi nënkupton ekzaminimin bazuar në testim të cilit i nënshtrohen dëshmitë që mbështesin shumat e shpalosura në pasqyrat financiare. Auditimi gjithashtu përfshinë edhe vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të cilat janë përdorur dhe vlerësimet e rëndësishme që janë bërë nga ana e menaxhmentit, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të prezantimit të pasqyrave financiare .

#### Bazat për dhënien e mendimit

Siq është shpalosur në shënimin nr. 11 të pasqyrave financiare, përveq pagave të cilat i takojnë periudhës 01.01.2009-31.12.2009, gjat vitit 2009 janë paguar edhe pagat për 22 punëtor të NJ. P. “Ujman” për vitin 2008 në shumën prej 116,403.00 Euro të cilat nuk janë përfshirë në shpenzimet e pagave për vitin 2009. Për këtë shumë është korrigjuar pasqyra e vitit paraparak-humbja e bartur në bilancin e gjendjes e cila po ashtu ka pasur ndikim edhe në Ekuitetin e vitit 2008.


Sikur në vitin paraparak po ashtu edhe në këtë periudhë, bazuar në Rregulloren e Tatimit në Fitim, për qëllime të tatimit kompania përdorë koston historike të mjeteve themelore si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit të mjeteve themelore përderisa për kontabilitetin e Ndërmarrjes si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit merret baza e rivlersuar e aseteve si dhe shkallët e zhvlerësimit të përcaktuara nga ana e rivlersuesve. Si rezultat i kësaj ndodhin diferencat në shpenzimet e zhvlerësimit të cilat diferenca rregullohen në Deklaratat vjetore të Tatimit në të Ardhura të Korporatave.

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

Mendimi

Sipas opinionit tonë, me rezervën e efekteve të rregullimeve, nëse do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për tu bindur për saktësinë e transaksioneve të N.H.,Iber-Lepenc,,SH.A. Pasqyrat Financiare të lartpërmendura në të gjitha aspektet materiale paraqesin në mënyrë të drejtë pozitën financiare të N.H.”Iber –Lepenc” SH.A. të datës 31 Dhjetor 2009, konform me Standardet Kosovare të Konabilitetit dhe SNA.

N.Sh. “Univerzum Audit”

  
Besa Borisha-Auditore Ligjore



Prishtinë ,  
Shkurt, 2010



### **1- Informata të përgjithshme**

Ndërmarrja Hidroekonomike „Iber-Lepenc,, Sh.A. është shoqëri aksionare e inkuorporuar me datën 01.02.2008 , ndërsa e regjistruar me 31.12.2007 , me numër të biznesit 70465157.

Në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje.

Ligji për Shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

#### **Struktura e kapitalit**

N.H.“Ibër Lepenc”SH.A është njëra nga tetë ndërmarrjet publike qendrore të Republikës së Kosovës e organizuar si shoqëri aksionare e cila përmes Bordit të drejtorëve i përgjigjet drejtpërsëdrejti Qeverisë së Kosovës si aksionar i vetëm.

Në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087), Qeveria e Republikës së Kosovës, ka emëruar Bordin e drejtorëve, i cili më 26.06.2009, ka aprovuar Statutin e ri të ndërmarrjes, të organizuar si ndërmarrje e nivelit qendror, përkatësisht ndërmarrje e Republikës së Kosovës, aksionar i të cilës në lartësi 100% është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000 Euro.

Adresa e zyrës qëndron në rrugën „Bill Klinton,, nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

#### **-Aktivitetet dhe veprimtaria afariste**

**Ndër aktivitetet kryesore te Kompanisë janë :**

- Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e energjise elektrike
- Furnizimi me ujë me shumicë për qendrat e përpunimit të ujit për nevojat e përdoruesve në industri, bujqësi dhe popullatës
- Ujitja e tokave bujqësore

#### **-Fushëveprimi- Objektivat dhe shtrirja e auditimit**

Auditimi është përformuar në harmoni me SNA. Standardet e përmendura kërkojnë që ne të planifikojmë dhe ekzekutojmë auditimin në mënyrë që të nxjerrret një siguri e arsyeshme se gjendjet e prezentuara në Pasqyrat Financiare nuk kanë pasur keqpohime materiale apo ndryshime. Auditimi jonë përmbanë hulumtimin e informatave të mbledhura të rëndomta për të vërtetuar shumat dhe informatat e prezentuara në raportin financiar. Po ashtu përmbanë hulumtimin dhe mendimin mbi politikat e kontabilitetit të cilat janë aplikuar, duke i dhënë rëndësi të veçant, se si janë bërë ato nga menaxhmenti, dhe hulumtimi mbi prezentimin gjeneral të kontove të entitetit.

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**PASQYRA E TË ARDHURAVE**

		2009	2008
Shitjet e faturuara nga veprimtaria themelore		3,379,084	2,619,750
Të Hyrat tjera		184,087	626,852
<b>Gjithsejtë të Hyrat</b>	10	<b>3,563,171</b>	<b>3,246,602</b>
Shpenz.Direkte të materialit të prodhimeve te shitura			
<b>Fitimi Bruto</b>		<b>3,563,171</b>	<b>3,246,602</b>

**Shpenzimet Operative**

Pagat bruto	11	2,093,709	1,779,970
Mirëmbajtja dhe Riparimet		112,822	86,130
Shpenzimet Administrative	12	46,502	29,123
Rryma elektrike		72,701	123,245
Shpenzimet e Derivateve		29,591	49,281
Shpenzimet për shërbime		44,821	15,398
Mallëra dhe material		26,681	50,671
Shlyerja e borgjeve të kqija			
Materil hargjus dhe taksa		197,908	175,237
Gjithsejtë Shpenzimet Operative	13	2,624,735	2,309,055
<b>Fitimi Operative para zhvleftësimit të mjeteve</b>		<b>938,436</b>	<b>937,547</b>
Zhveftësimi i Mjeteve të punës			
Inventari, Paimet, Makinat (edhe ato të marra në shfrytëzim)		184,094	175,380
Ndërtesat dhe Toka		4,298,649	4,283,523
Gjithsejtë Zhvleftësimi i mjeteve	14	4,482,743	4,458,903

**Fitimi Operative pas zhvleftësimit të mjeteve**

-3,544,307 3,521,356

Të Hyrat dhe të Dalurat Financiare

Të Hyrat Financiare

Të Dalurat financiare

Gjithsejtë të Hyrat Financiare

0

0

**E Ardhura para Tatimit dhe Rezervave të pa tatimuar**

-3,544,307 -3521356

Tatimi në fitim

**Fitimi ( Humbja )**

-3,544,307 -3521356

**Te punësuar Nr.**

247

182

Konfirmoi: Hajdar Beqa

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv

Përpiloi: Sheremet Smakolli

Pozita: Drejtor financiar





PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**BILANCI I GJENDJES**

		2009	2008
<b>MJETET</b>			
<b>Mjetet Qarkulluese</b>		<b>5,028,581</b>	<b>5,544,196</b>
Arka dhe Xhirologaria	3	2,803,482	2,926,886
Logaritë e Arketueshme	4	1,346,260	1,842,469
Kërkesat tjera afat shkurte		3,122	1,389
Shpenz. e parapaguara dhe të hyrat e akruale		545	
Stoqet	5	875,172	773,452
Avanset e paguara Furnitorëve			
<b>Mjetet Fikse</b>	<b>6</b>	<b>147,723,274</b>	<b>151,008,500</b>
Kërkesat afat gjate			
Depozitet, kaparet			
Akcionet dhe pjesëmarjet			
Inventari, Paimet dhe Makinat		2,659,073	2,646,908
Ndërtesat		145,064,201	148,361,592
Toka			
<b>Gjithsejtë MJETET</b>		<b>152,751,855</b>	<b>156,552,696</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrimet afat shkurtëra</b>		<b>243,326</b>	<b>350,508</b>
Logaritë e pagueshme		97,240	112,639
Tatimi në të Ardhurën, i pagueshëm		17,125	31,849
Shpenzimet akruale dhe Avanset e marruna			
Huatë afat shkurtëra			
Detyrimet tjera afat shkurta		128961	206020
<b>Detyrimet afat gjate</b>		<b>1,048,834</b>	<b>1,081,783</b>
Të hyrat e shtyra	7	295,765	328,714
Mbiterheqjet bankare			
Huatë afat gjate		753,069	753,069
<b>Gjithsejtë Detyrimet</b>	<b>8</b>	<b>1,292,160</b>	<b>1,432,291</b>
<b>Kapitali</b>	<b>9</b>	<b>151,459,695</b>	<b>155,120,405</b>
Akcionet		25,000	25,000
Vlera historike e Aseteve të Ndërmarjes		162,419,111	162,419,111
Ndihmat, Grantet, Dhuratat- e kapitalizuara			
Fitimet ( Rezultatet ) e bartura		-7,440,109	-7,323,706
<b>Fitimi i periudhës raportuese</b>		<b>-3,544,307</b>	
<b>Gjithsejtë Detyrimet dhe Kapitali</b>		<b>152,751,855</b>	<b>156,552,696</b>



**Pasqyra e rrjedhes së parasë së gatshme**

**Periudha raportuese**  
2009

<b>A.</b>	<b>Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</b>	
	Inkasimet nga aktivitetet operative	4,390,905
	Inkasimet e tjera	2,168
	Pagesat ndaj furnitorëve	(635,325)
	Pagesat për pagat e punëtorëve	(2,307,855)
	Pagesat e tjera (TVSH, avanset, shërbime dhe konsulencë, dëmet)	(327,682)
	<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operative</b>	<b>1,122,211</b>
<b>B.</b>	<b>Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</b>	
	Investimet kapitale	(1,419,883)
	Inkasimet nga shitja e mjeteve themelore	31,435
	<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese</b>	<b>(1,388,448)</b>
<b>C.</b>	<b>Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet finaniare</b>	
	Inkasimet nga interesi ne depozita	145,885
	Pagesa e tatimit ne interes	(3,052)
	<b>Gjithshejt rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet finaniare</b>	<b>142,833</b>
	<b>Ndryshimet në mjetet qarkulluese</b>	<b>(123,404)</b>
	<b>Paraja e gatshme në fillim të vitit</b>	<b>2,926,886</b>
	<b>Paraja e gatshme në fund të vitit</b>	<b>2,803,482</b>

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

VITI	KAPITALI AKSIONAR	REZERVA E RIVLERËSUAR	FITIMI / HUMBJA	NETO EKUITETI
Me 31.12.2007	25,000	162,419,111	(3,802,350)	158,641,761
Fitimi (Humbja) -2008	25,000		(3,521,356)	(3,521,356)
Me 31.12.2008		162,419,111	(7,323,706)	155,120,405
Korr. per shp. e pagave			(116,403)	(116,403)
Me 31.12.2008			(7,440,109)	155,004,002
Fitimi (Humbja) -2009			(3,544,307)	(3,544,307)
Me 31.12.2009	25,000	162,419,111	(10,984,416)	151,459,695

## **2. PASQYRA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgaditur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të adoptuara në Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

### **2.2. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në pajtueshmëri me konventën e kostos historike, por njëkohësisht e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe paisjeve në shumat e rivlersuara.

Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe poqese nuk ceket ndryshe, janë konsistente me ato që janë miratuar në vitin e kaluar financiar.

Përgatitja e pasqyrave financiare konform të SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Githashtu këkojnë menaxhmentit të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit.

Periudha raportuese e Shoqërisë përfshin një periudhë dymbëdhjetë mujore duke përfunduar me 31 Dhjetor të çdo viti. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë krahasuese duke paraqitur në këtë mënyrë saldot për vitin e tanishëm dhe të kaluar.

### **2.3. Valuta e këmbimit**

Monedha raportuese e N.H.,Iber-Lepenc,,SH.A. është njësia monetare e Unionit European (EUR). Transaksionet në monedhat tjera përveç euros janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

Transaksionet e valutës së huaj konvertohen duke përdorur normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Çfarëdo lloj përfitimesh apo humbjesh, që kanë të bëjnë me harmonizimin e shumave, të pagueshme ose të arkëtueshme, njihen në pasqyrën e të ardhurave

### **2.4. Prona, impiantet dhe paisjet**

Zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve me 01.01.2009 janë bartur sipas kostos minus zhvlersimi i aukumuluar. Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet direkt blerjes.

Një zë nga pajisjet dhe makineritë largohet nga bilanci i gjendjes kur shitet ose kur tërheqet nga përdorimi dhe kur nuk pritet ndonjë benefit i ardhshëm nga ato.

Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën operative atëherë kur ndodhin shpenzimet.

Ngarkimi vjetor për amortizimin llogaritet duke përdorur metodën lineare për të gjitha kategoritë e pronës, toka nuk është e zhvlerësuar.

Shkalla e zhvlerësimit të aseteve sipas pëcaktimit të vlerësuesve mbi jetën e përdorimit dallon nga shkalla e zhvlerësimit sipas Rregulloreve në fuqi:



PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

Ndëtesa.....	1%-2%
Paisjet e rënda industriale.....	5%-15%
Veturat.....	5%-20%
Paisje për zyre dhe kompjuter.....	10%-20%

## 2.5. Stoqet

Stoqet janë vlerëuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës në rrjedha normale të biznesit, zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes.

Kostoja e stoqeve është e përcaktuar në bazë të formulës i pari brenda-i pari jashtë apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stoqet e blera me çmimin e parë i trajton dalje të para.

## 2.6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme, paraja përfshinë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

## 2.7. Kapitali aksionarë

Kapitali aksionarë përbëhet nga vlera monetare e kontribuar nga aksionarët e Kompanisë.

## 2.8. Rezervat

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendjen fillestare të bilancit të gjendjes në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitalit fillestar të kontribuar nga aksionarët e Kompanisë.

## 2.9. Kontributi shtesë për të punësuarit

Ndërmarrja duke u bazuar në moshën mesatare të të punësuarve, kontributin e tyre në ndërmarrje, procedurave aktuale të pensionimit, përveç kontributit pensional të obligueshëm sipas legjislacionit në fuqi ka vendosur politika të ndarjes së kontributeve shtesë për të punësuarit. Këto kontribute shtesë i ngarkojnë shpenzimet e pagave në pasqyrat e të ardhurave sipas periudhave kohore kur ndodhin. Ndërmarrja me qëllim të menaxhimit më të mirë dhe pagesës së mëvonshme (si është përshkruar në Planin Pensional, FSKP-1) të këtyre mjeteve ka lidhur kontratë me Fondin Slloveno-Kosovar të Pensioneve si fond pensional suplementar.



#### **2.10. Politikat tatimore**

Në bazë të organizimit si ndërmarrje publike me statut të shoqërisë akcionare, ndërmarrja ju nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të cilat rregullojnë lami të caktuara në të cilat aplikohet tatimi në vlerën e shtuar, kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura personale si dhe sipas Ligjit Nr.03/L-113 për Tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat e tatueshme të korporatave me normë prej 10% i kalkuluar sipas Deklaratës vjetore të tatimit në fitim

#### **2.11. Detyrimet tatimore**

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2009 nuk janë inspektuar nga autoriteti tatimor vendor. Detyrimet e tatimeve të kompanisë nuk mundë të konsiderohen të përfunduara. Taksat shtesë që mundë të dalin gjatë inspektimit nuk mundë të vlerësohen me saktësi.

#### **2.12. Njohja e të hyrave operative**

Të hyrat e Kompanisë janë kryesisht të hyra të cilat relizohen nga veprimtaria primare e entitetit. Të hyrat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të Kompanisë dhe kur shuma e të hyrave mundë të matet besueshëm. Shitjet njihen si shitje neto të tatueshme dhe zbritjet kur është bërë dërgesa dhe transferimi i rrezikut dhe pagesa është bërë.

#### **2.13. Shpenzimet**

Njohja e shpenzimeve bëhet vetëm kur pasuritë ekonomike të ndërmarrjes të shoqëruara me transaksione konsumohen për prodhimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave vetëm kur ato ndodhin sipas parimit akrual të kontabilitetit.

#### **2.14. Grantet qeveritare**

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme që grantet do të mirren dhe kompania do të përmbushë kushtet e bashkangjitura.

### **2.15. Politika e vazhdimit të veprimtarisë**

Ndërmarrja ka të aprovuar planin trevjeçar 2010-2012 ku janë paraqitur synimet dhe objektivat e ndërmarrjes në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e aseteve dhe shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve që do të siguronin edhe ngritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

### **2.16. Politika e rritjes së kontrollit të brendshëm**

Pas transformimit në shoqëri akcionare me qëllim të rritjes së kontrollit të brendshëm, ndërmarrja sipas Ligji për Shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) ka punësuar Zyrtarin për Auditim të Brendshëm.

### **2.17. Menaxhmenti i riskut financiarë dhe kapital**

Menaxhmenti i riskut të Kompanisë përbëhet nga Bordi i drejtorëve. Kompania ka politika të vendosura që shitja e të mirave dhe shërbimeve u bëhen klientëve me një histori kreditore të pastër. Objektivat e Kompanisë kur menaxhojnë me kapital janë të ruajnë mundësinë që Kompania të vazhdoj me punë në të ardhmen.

### **2.18. Huamarrja**

Huaja e marrur nga ish – Departamenti i Shërbimeve Publike – paraardhësi i AKM-së në vitin 2000 nuk është amortizuar dhe nuk është kthyer asnjë këst. Kjo është bartur si detyrim në Ndërmarrjen Holding me rastin e korporatizimit dhe si i tillë është bartur prap si detyrim në Ndërmarrjen aktuale.

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**3.Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

	Më 31.12.2009	Më 31.12.2008
Depozitat afatshkurtëra në banka	2,000,000.00	1,512,640
Llogaritë e tanishme në banka	801,589.62	1,412,484
Arka	1,892.19	1,762
<b>Gjithsejt</b>	<b>2,803,481.81</b>	<b>2,926,886</b>

**4.Llogaritë e Arkëtueshme**

**Të arkëtueshmet tregtare**

	Më 31.12.2009	Më 31.12.2008
Klientët e furnizimeve me rrymë eletrike	225,707.00	530,316
Klientet e furnizimeve me ujë industrial	989,094.22	1,177,900
Klientet e shërbimit të ujitjes	78,852.77	65,788
<b>Total</b>	<b>1,293,653.99</b>	<b>1,774,004</b>

**Të arkëtueshme tjera rrjedhëse**

Avanset e furnizuesve		
Huatë pa interes	51,106.00	66,081.00
Të arkëtueshmet tjera	1,499.88	2,000.00
<b>Total</b>	<b>52,605.88</b>	<b>68,081.00</b>

**Gjithsejt të arkëtueshmet** **1,346,260.00** **1,842,085**

**5. Stoqet**

	Më 31.12.2009	Më 31.12.2008
Lënda e parë dhe paisjet rezervë	875,172.00	773,452
<b>Total</b>	<b>875,172.00</b>	<b>773,452</b>

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**6.Prona, impiantet dhe paisjet**

**Më 01.01.2009**

	<b>Ndërtesat</b>	<b>Paisjet e rënda</b>	<b>Paisjet tjera</b>	<b>Totali</b>
Vlera aktuale:	152,645,113	2,159,578	662,712	155,467,403
Zhvllrs.i akumul.:	(4,283,523)	(83,022)	(92,358)	(4,458,903)
<b>VI. bartëse neto:</b>	<b>148,361,590</b>	<b>2,076,556</b>	<b>570,354</b>	<b>151,008,500</b>

**Më 31.12.2009**

	<b>Ndërtesat</b>	<b>Paisjet e rënda</b>	<b>Paisjet tjera</b>	<b>Totali</b>
Vlera aktuale	148,361,590	2,076,556	570,354	151,007,500
Shtesat	1,001,258	-----	224,142	1,225,401
Çregjistrimet	-----	-----	(27,884)	27,884
<b>Gjithsejt</b>	<b>149,362,849</b>	<b>2,076,556</b>	<b>766,612</b>	<b>152,206,016</b>

**Më 31.12.2009**

	<b>Ndërtesat</b>	<b>Paisjet e rënda</b>	<b>Paisjet tjera</b>	<b>Totali</b>
Vlera aktuale	149,362,849	2,076,556	766,612	152,206,016
Zhvl. i akumuluar	(4,298,648)	(83,200)	(101,071)	(4,482,742)
<b>Vlera bartëse neto</b>	<b>145,064,201</b>	<b>1,992,533</b>	<b>666,541</b>	<b>147,723,274</b>

Gjat vitit 2009 N.H.” Iber-Lepenc” SH.A. ka bërë investime në vlerë prej 1,001,258 €, ka blerë paisje tjera në vlerë prej 224,142 €, si dhe njëkohësisht ka bërë edhe çregjistrimin(shitje) e paisjeve tjera në vlerë prej 27,884 €.

Vlera e gjithëmbarshme e Mjeteve fikse është 147,723,274 euro.

**7.Të hyrat e shtyera**

	<b>Më 31.12.2009</b>	<b>Më 31.12.2008</b>
Grantet ( vlera e mbetur)	295,063	328,714
Avancet e marruna	702	
<b>Gjithsejt</b>	<b>295,765</b>	<b>328,714</b>



PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**8. Detyrimet tregtare dhe të tjera**

	Më 31.12.2009	Më 31.12.2008
Furnitorët vendorë	97,240	112,639
Detyrimet ndaj kredisë	753,069	753,069
Detyrimet ndaj pagave të punëtorëve	17,125	206,020
Detyrimet tjera	128,961	31,849
Donacionet	295,765	328,714
<b>Gjithsejt detyrimet</b>	<b>1,292,160</b>	<b>1,432,291</b>

**Kapitali aksionar**

Sipas të dhënave nga dosja e Regjistrimit, kapitali aksionarë i N.H.” Iber-Lepenc” SH.A ka shumën prej 25,000.00 €.

**9.Ndryshimet në ekuitet**

Fitimi/humbja/ kapit.aksion.	Rez. E rivlersimit	Fitimi/humbja	Neto ekuiteti
		(3,544,307)	(3,544,307)
<b>Më 31.12.2009</b>	<b>25,000.00</b>	<b>162,419,111</b>	<b>151,459,695</b>

**10.Shitjet**

	Më 31.12.2009	Më 31.12.2008
Të hyrat nga energjia elektrike	2,128,008	1,324,968
Të hyrat nga uji industrial	1,137,046	1,169,530
Shërbimet e ujitjes	114,031	125,252
Të tjera	52,635	626,852
<b>Gjithsejt</b>	<b>3,431,720</b>	<b>3,246,602</b>
<b>Të hyrat financiare</b>	<b>131,451</b>	
<b>Gjithsejt të hyrat</b>	<b>3,563,171</b>	<b>3,246,602</b>

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**Rezultati financiarë neto**

<b>Të hyrat financiar</b>	<b>Më 31.12.2009</b>	<b>Më 31.12.2008</b>
Të hyrat nga interesi	131,117	96,632
Të hyrat nga denimi i penetoreve	334	163
<b>Total</b>	<b>131,451</b>	<b>97,366</b>

**Shpenzimet financiare**

	<b>Më 31.12.2009</b>	<b>Më 31.12.2008</b>
Shpenzimet e interesit	(387)	(564)
Tatimi në interes	(8,212)	(16,762)
<b>Gjithsejt</b>	<b>(8,599)</b>	<b>(17,326)</b>

<b>Të hyrat financiare neto</b>	<b>122,852</b>	<b>80,040</b>
---------------------------------	----------------	---------------

**11. Kosto e stafit**

	<b>Më 31.12.2009</b>	<b>Më 31.12.2008</b>
Pagat neto	1,742,569	1,471,468
Tatimi dhe kontributet	351,140	303,990
Shtesat tjera		4,512
<b>Gjithsejt</b>	<b>2,093,709</b>	<b>1,779,970</b>

Pagat për 22 punëtor të NJ P. “Ujman” për vitin 2008 janë paguar në vitin 2009 në shumën prej 116.403 Euro të cilat nuk janë përfshirë në shpenzimet e pagave për vitin 2009. Për këtë shumë është korrigjuar pasqyra e vitit paraprak-humbja e bartur në bilancin e gjendjes .

**12.Shpenzimet administrative**

	<b>Më 31.12.2009</b>
Shpenzimet e udhëtimt zyrtarë/akomodimi	14,638
Shpenzimet komunale	14,352
Material për zyrë	7,282
Shpenzime tjera komunale	10,282
<b>Gjithsejt shpenzimet administrative</b>	<b>46,502</b>

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR  
N.H „Iber –Lepenc,, SH.A.

**13.Shpenzimet operative**

	<b>Më 31.12.2009</b>	<b>Më 31.12.2008</b>
Shpenz. e mirëmbajtjes dhe riparime	112,822.00	86,130.00
Shpenz. Administrative	46,502.00	29,123.00
Shpenz. e energj. elektrike	72,701.00	123,245.00
Shpenz. e derivateve	29,591.00	49,281.00
Shpenz. për shërbime	44,821.00	15,398.00
Shpenz. e mallërave dhe materialit	26,681.00	50,671.00
Shpenz. për material hargjues dhe taksa	197,908.00	175,237.00
<b>Gjithsejt</b>	<b>531,026.00</b>	<b>529,085.00</b>

**14.Shpenzimet e zhvlerësimit**

				<b>Më 31.12.2009</b>
	<b>Ndërtesat</b>	<b>Paisjet e rënda</b>	<b>Paisjet tjera</b>	<b>Totali</b>
Vlera aktuale	149,362,849	2,076,556	766,612	152,206,016
<b>Zhvl. i akumuluar</b>	<b>(4,298,648)</b>	<b>(83,200)</b>	<b>(101,071)</b>	<b>(4,482,742)</b>

### **Njohja dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe sistemit të kontabilitetit**

Kemi zgjedhur strategjinë e mosbesimit apo (testeve të pavarura) në kontrollin e brendshëm. Kemi bërë biseda me nivelin e duhur të menaxhmentit, mbikëqyrësve dhe personelit tjetër. Është bërë ekzaminimi i dokumentacionit, raporteve dhe dosjeve elektronike, si dhe është vëzhguar aplikimi i kontrolleve të veçanta të brendshme.

Gjatë procedurave audituese, në bazë të asaj që kemi arritur të shohim, mund të konstatojmë se këtu kontrollohen të gjitha raportet dhe dokumentet tjera financiare , dhe po ashtu këto raporte janë të aprovuar edhe nga drejtorët dhe anëtarët e bordit.

Vlenë të theksohet se N.H. "Iber Lepenc" përmbyll vitin me një humbje prej 3,544,307 euro e cila humbje vie si rezultat i shpenzimeve të zhvlerësimit në vlerë prej 4,482,743 euro.

Edhe pse humbja është relativisht e lartë nuk mundë të themi se vie në rrezik vijimësia e biznesit derisa fitimi operativ para zhvlerësimit është në vlerë 938,436 euro.

Ne po ashtu jemi siguruar se :

Kontot/llogaritë e N.H "Iber-Lepenc" SH.A. , japin një pasqyrë të vërtetë dhe të plotë të asetëve dhe transakcioneve financiare, si në fushën e përgjegjësisë materiale, ligjore dhe financiare, si të hyrave të krijuara si rezultat i aktiviteteve të parapara , po ashtu edhe të shpenzimeve.

Kontot për prezentimin e llogarive janë në harmoni me shumatat e prezentuara dhe të regjistruara.

Auditimi është kryer në harmoni me rregullat e kërkuara në instrukcionet e auditimit lidhur me kryerjen e detyrave të auditimit

I gjith personeli ka treguar një kooperativitet të lartë

Të gjitha shënimet e kërkuara janë ofruar të plota

Sigurimi i dëshmive dhe testeve gjatë procesit të Auditimit

Në N.H "Iber-Lepenc" SH.A kemi kryer një sërë testesh përmes mostrave të dëshmive autentike. Punën e testimit dhe sigurimit të dëshmive kryesisht e kemi zhvilluar me ndihmën e stafit të entitetit ku do të prezentojmë disa prej dëshmive dhe mostrave të zgjedhura nga arkivi i librave të kontabilitetit dhe dokumentacionit tjetër që janë shfrytëzuar gjatë auditimit.

-Kontratat në mes të entitetit dhe partnerëve afarist

-Marrëveshja në mes të entitetit dhe të punësuarëve të rregullt dhe kontraktorëve/ apo personelit i cili angazhohet më gjat sezonave kur ka projekte

-Dokumentet e kontabilitetit të cilat janë subjekt i auditimit

-Pasqyrat financiare dhe të aktiviteteve lidhur me entitetin

-Raportet e punës së Auditorit të brendshëm

-Procesverbalin e mbledjes se bordit drejtues

-Çdo dokument tjetër i cili ka të bëjë me entitetin.